



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-02065-9578/24 më 17-01-2024

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet caktimi i grupit punues për analizimin e çështjes së nën-stacionit kryesor të NPL "Termokos" që evidentohet në parcelën 2725/1 në Bregun e Diellit.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, grupi punues është në këtë përbërje:
 1. Adnan Berisha, Drejtorja e Pronës, anëtar;
 2. Sazan Raskova, Drejtorja e Planifikimit Strategjik, anëtare;
 3. Ymer Ratkoceri, Drejtorja e Kadastrit, anëtar;
 4. Behar Mehana, Drejtorja e Kadastrit, anëtar;
 5. Rina Govori, Sektori Ligjor, anëtare;
 6. Faton Shatmani, NPL "Termokos", anëtar.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, detyrë e grupit punues është analizimi i gjendjes reale dhe faktike të parcelës 2725/1, parcelë në të cilën është i vendosur nën stacioni kryesor i NPL "Termokos" dhe konkluzioni mbi të gjeturat.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Anëtarëve të Grupit punues;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

